



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 32

Datë: 30. 03. 2021. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

Këshilli për Çështje Ligjore;

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për kandidatët e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

- 3. Të ndryshme**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Fillojmë me mbledhjen e 32-të. Kush është për këtë rend dite ?

Miratohet.

2.Raporti i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për kandidatët e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës:

Arianit Elshani: Këshilli për Çështje Ligjore ka shqyrtuar kërkesën që ka ardhur nga Presidenca lidhur me zëvendësimin e deputetëve. Kjo kërkesë, është e bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, dhe ne kemi shqyrtuar si këshill ndryshimet që kanë ndodhur. Në kontekst, ne si këshill, rekomandojmë zëvendësimin...

Valdete Daka: Pas shpalljes së aktgjyqimit, kemi kërkesën nga presidenca për rishqyrtimin e vendimit tonë për rekomandim të zëvendësimit të kandidatëve të radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mbase që e kemi rekomandimin, unë do ti lexoj emrat e kandidatëve që do ti zëvendësojnë deputetët të cilët janë emëruar në pozita tjera:

1.Nga subjekti politik “Nova Demokratska Stranka”, në vend të znj. Emilia Rexhepi, deputete do të jetë zonja Samara Ilijaz.

2.Nga subjekti politik “Iniciativa e re demokratike” - IRDK”, në vend të z. Elbert Krasniqi, deputet do të jetë z. Fridan Lala.

3. Nga subjekti politik “Aleanca për Adhmërinë e Kosovës, në vend të z. Daut Haradinaj, deputet do të jetë z. Shemsedin Dreshaj.

4. Nga subjekti politik Lëvizja “Vetëndosje!”, në vend të deputetëve: Donika Gërvalla – Shvarc, Hekuran Murati, Arben Vitia, Arbërie Nagavci, Hajrulla Ceku, Liburn Aliu, Faton Peci, Xhelal Svecla dhe Rozeta Hajdari, deputet do të jenë:

Enver Haliti, Shqipe Isufi, Mirsad Shkreta, Gramoz Agusholli, Alban Bajrami, Jahja Koka, Hydajet Hyseni, Ekrem Mustafa, Enver Dugolli.

5.Nga subjekti politik “KDTP”, në vend të z. Fikrim Damka, deputet do të jetë z. Enis Keron.

Miratohen këto zëvendësime.

4. Të ndryshme